



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program

Zbatimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit (TIK) në procesin mësimor (2013/2014)

Fakulteti	Shkencat dhe Teknologjitë Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Titulli	Magjistër i shkencave kompjuterike - Drejtimi: Zbatimi i TIK në procesin mësimor
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-371/4
Data akreditimit	14.05.2013

Përshkrimi i programit

Studimet e ciklit të dytë në zbatimin e teknologjive të informacionit dhe të komunikimit (TIK) në procesin mësimor - 120 ECTS është një program koheziv studimi i dizajnuar për të rritur njohuritë, aftësitë dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe të tjerëve me një qasje bashkëkohore për adoptimin e njohurive të reja. Këto studime master përqendrohen në shfrytëzimin sa më efektiv të teknologjisë në fushën e arsimit dhe mësimdhënies. Gjatë këtyre studimeve fitohen njohuri të reja rreth asaj se si të hartohet një program që bazohet në teknologjinë, përdorimin e teknologjive të informacionit për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e orëve, si dhe përdorimin dhe zhvillimin e platformave për të mësuar. Po ashtu në këtë cikël bëhet krijimi i përmbajtjeve arsimore digjitale, e-mësim, aplikacione arsimore dhe projekte multimediale në klasë. E tërë kjo ofron zhvillimin profesional për mësuesit dhe të interesuarit të tjerë për studime në arsim. Studimet janë të bazuara në hulumtimet e fundit dhe në praktikën në e-mësim dhe përmirësimin e të mësuarit përmes TIK. Ky program zhvillon aftësitë praktike dhe të kuptuarit analitik të TIK si dhe të nxënësve elektronik dhe rolit të tij në praktikën profesionale.

Karriera

Studenti i cili do ta përfundojë këtë program studimor do të aftësohet për:

- zbatimin e TIK në procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit – kontrollimit;
- dizajnimin e lëndëve moderne;
- dizajnimin e lëndëve për studentë me nevojë të veçanta;
- ndjekjen dhe të kuptuarit e trendeve zhvillimore të TIK dhe zbatimin e saj në mësimdhënien moderne.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Aftësi për zhvillimin dhe aplikimin e TI ideve origjinale dhe kreative me qëllim sigurimin e kualitetit të mësimdhënies.
- Aftësi për aplikimin e TI shkathtësive dhe njohurive dhe demonstrimin e kompetencave speciale nga shkencat kompjuterike dhe informatika me qëllim organizimin e mësimdhënies interaktive në arsim.
- Posedimi i njohurive dhe të kuptuarit nga fusha e shkencave kompjuterike, inxhinieri (programim, ueb teknologjitë, bazat e

të dhënave, hyrje në rrjeta, sistemet kompjuterike dhe të informacionit dhe multimedia);

- Posedon njohuri nga një ose më shumë fusha që mund ta karakterizojnë studentin si ekspert në aplikimin e njohurive në fushën e dhënë.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësia që në mënyrë kritike, të pavarur dhe kreative të zgjidhin probleme të pa njohura deri atëherë ose në rrethina me të cilat nuk kanë përvojë paraprake në arsim. - ---Planifikimi, udhëheqja dhe evaluimi i hulumtimeve të pavarura në domenin e arsimit por edhe krijimin dhe implementimin e materialeve përkatëse interaktive, mjeteve multimediale për mësim dhe on-line testimet përmes lojërave;

- Kreativiteti dhe origjinaliteti në interpretimin e dijes nga informatika për të zgjidhur problemet që lidhen me objektivat dhe materiale në fushën ku ata japin mësim;

Aftësitë për të vlerësuar

- Aftësi për integrim kreativ dhe sintezë e njohurive nga më shumë fusha në arsim, si dhe administrimi i procesit arsimor dhe evaluimi i nxënësve me aplikimin e mjeteve të TI të krijuara për një problematikë të caktuar. Krijimi i proceseve edukative me përdorimin e veglave dhe teknikave kompjuterike;

- Aftësi për t'u përballur me situata komplekse që lidhen me proceset specifike arsimore që rezultojnë në kohë reale në arsim;

- Aftësi për të identifikuar instancat e duhura të specializuara në arsim dhe sjelljen e vendimeve të bazuara në mungesë të informatave të kompletuara ose të dhënave të bazuara në parimet personale, sociale dhe etike dhe përgjegjësitë e lidhura me aplikimin e njohurive dhe të kuptuarit;

Aftësitë e komunikimit

- Aftësi për këmbimin e përfundimeve dhe sugjerimeve me argumentim dhe mbështetje e arsyeshme e tyre, si me njerëz ekspertë ashtu edhe me joekspertë, qartë dhe pa mëdyshje;

- Marrja e përgjegjësisë të konsiderueshme për rezultatet e përbashkëta;

- Drejtimi dhe inicimi i aktiviteteve.

Aftësitë e të mësuarit

- Aftësia për identifikimin e nevojave personale dhe të drejtimeve për kualifikim individual dhe autonom dhe performancën e saj të pavarur dhe autonome në fushat e zakonshme informatike;

- Aftësi për marrjen e përgjegjësisë për studim të vazhdueshëm individual në fushat e specializuara të biznesit dhe informatikës në kuadër të rrjetit ekonomik;

- Aftësi për marrjen e përgjegjësisë për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtutjeshëm profesional.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [MAICTT-101] [6.0 SETK] **Hyrje në teknologjitë arsimore**
- [MAICTT-102] [6.0 SETK] **Sistemet kompjuterike**
- [EMAICTT-303] [6.0 SETK] **Mësimdhënia dhe mësimnxënia përmes TIK**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 2

- [MAICTT-201] [6.0 SETK] **Softueri i dedikuar për arsim**
- [MAICTT-202] [6.0 SETK] **Teknologjitë ndihmëse për nxënësit me nevoja të veçanta**
- [MAICTT-203] [6.0 SETK] **Multimedia në arsim**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 3

- [MAICTT-103] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [MAICTT-301] [6.0 SETK] **Hyrje në bazat e të dhënave**
- [MAICTT-302] [6.0 SETK] **Etika profesionale e teknologjive të informacionit**
- [MAICTT-303] [6.0 SETK] **E-mësimi 2.0 – teori dhe praktikë**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 4

- [MAICT4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Hyrje në teknologjitë arsimore**

Qëllimet e programit të lëndës: - Demonstrimi i njohurive, shkathtësive dhe koncepteve të lidhura me teknologjinë dhe kompjuterin; - Shfrytëzimi i teknologjive aktuale dhe i teknologjive të reja për përmirësimin dhe integrimin e mësimdhënies, instruksioneve, ligjëritimit dhe mësimin; - Identifikon, vlerëson / shikon përshtatshmërinë e softuerit kompjuterik për përdorime në mësimdhënie si dhe përshtatshmërinë dhe adoptimin për nxënës me nevoja të veçanta; - Identifikon dhe shfrytëzon faqe dhe burime të përshtatshme nga Interneti për të përmirësuar mësimdhënien dhe të mësuarit; - Demonstrimi i përdorimit të kompjuterit për të krijuar materiale mësimore dhe përdorimi i softuerëve për fëmijë për përkrahje dhe përmirësim të mësimnxënies për të gjitha moshat e nxënësve; - Sjelljen e zgjedhjeve adekuate teknologjike për mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim dhe evaluim;

- **Sistemet kompjuterike**

Pas kryerjes së lëndës, studentët duhet: - T'i kuptojnë sistemet themelore kompjuterike dhe organizimin e tyre; - Të dinë të interpretojnë sisteme të ndryshëm numerikë; - Ta kuptojnë algjebërën e Bulit dhe përdorimin e saj; - T'i kuptojnë bazat e arkitekturës së kompjuterit; - Të bëjnë dallime mes sistemeve të ndryshëm operative dhe përdorimit të tyre; - T'i kuptojnë bazat e rrjetave kompjuterike;

- **Mësimdhënia dhe mësimnxënia përmes TIK**

Kjo lëndë synon të paraqesë ngjarjet më aktuale në tema të ndryshme nga fusha e TIK. Nëpërmjet një sërë seminaresh dhe ligjëratash të paraqitura nga ekspertë të industrisë dhe akademisë të po kësaj fushe, studentët do të vetëdijësohen për çështjet bashkëkohore, për problemet e ndryshme, zgjidhjet dhe pasojat në fushën e TIK. Pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje: - Ta vlerësojnë literaturën relevante hulumtuese dhe të bëjnë kërkime në fushën e TIK; - Të dëshmojnë njohuri gjithëpërfshirëse teorike dhe konceptuale nga lëmia e aplikimit të TIK në arsim; - Të zgjidhin probleme konkrete nga fusha e TIK; - Të zgjidhin probleme specifike përmes TIK; - T'i vlerësojnë në mënyrë kritike potencialet e mjeteve të shumta softuerike nga fusha e mësimin on line përmes TIK.

- **Softueri i dedikuar për arsim**

Qëllimi i programit të lëndës: - Përkufizimi i softuerit arsimor, domethënia e përdorimit të softuereve të ndryshme në procesin arsimor, mënyra e përdorimit, vlerësimi i përfitimeve nga përdorimi i softuerit arsimor; - Prezentimi i softuereve të ndryshëm arsimorë, softuerët e lirë dhe komercialë; - Përdorimi i softuerit arsimor për mësimin e disa lëndëve (si p.sh. lëndët nga shkencat e natyrës, gjuhës, etj.); - Parimet e dizajnit dhe inxhinieringu i softuerit arsimor.

- **Teknologjitë ndihmëse për nxënësit me nevoja të veçanta**

Qëllimi i lëndës është të ndihmojë studentët të mësojnë teknologjitë për të lehtësuar edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Ky kurs përfshin njohuri në lidhje me përdorimin e teknologjisë për shumë lloje të handikepesh, si të verbërisë, shurdhërisë, për nxënësit me pengesa motorike, etj. Kursi mbulon një pasqyrë të gjerë të përdorimit të teknologjive bashkëkohore dhe burimeve on line të cilat mund të përdoren për të ndihmuar studentët në detyrat e tyre të përditshme të parapara me planin mësimor.

- **Multimedia në arsim**

Qëllimet e lëndës janë që studentëve mundësojë: - fitimin e njohurive dhe aftësive themelore në fushën e multimedive; - fitimin e njohurive teorike dhe praktike në fushën e multimedias dhe zbatimin e tyre në orët mësimore; - zgjerimin dhe thellimin e njohurive të përgjithshme të koncepteve multimediale (tekst, fotografi, audio dhe video)

dhe përdorimin e të njëjtave në dizajnimin e procesit mësimdhënës; - atësimin për punë në projekte individuale apo në grup, që nga natyra mund të jenë – shkencore hulumtuese, projekte zhvillimore ose punë praktike.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë ofron një hyrje gjithëpërfshirëse në metodologjitë kërkimore, teoritë dhe protokollet themelore kërkimore, si dhe në shkrimin e propozimeve kërkimore. Studentët në këtë kurs do të mësojnë për natyrën ciklike të kërkimit të aplikuar dhe procesin iterativ të shkrimit kërkimor. Kursi i mëson studentët si ta identifikojnë temën e studimit, e si të formulojnë pyetje, të organizojnë grumbullim të literaturës dhe të zgjedhin projektet dhe metodologjitë e duhura kërkimore. Deri në fund të kursit, studentët do të përfundojnë një propozim që përfshin një hyrje, përkufizim të problemit (kuptimin e studimit), përmbledhje të literaturës, seksion për metodologjinë, referencat dhe orarin e projektit.

- **Hyrje në bazat e të dhënave**

Qëllimet e programit të lëndës: - Prezantimi i modelit konceptual dhe modelit të bazuar në entitetet dhe lidhjet, modelimi konceptual, E – R diagrami; - Prezantimi i modelit relacional; - Hyrje në gjuhën SQL; - Normalizimi i skemës së bazës së të dhënave; - Hyrje në sistemet për menaxhim të bazave të të dhënave, veglave për përkufizimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave, veglat për ndërtimin e formave dhe raporteve.

- **Etika profesionale e teknologjive të informacionit**

Kjo lëndë paraqet njohje me vlerat etike dhe morale në përgjithësi, si dhe mënyrën e përdorimit të teknologjive të informacionit në veçanti. Gjithashtu lënda është një hyrje në hartimin dhe zbatimin e kodekseve etike e profesionale të TI në institucione publike dhe private. Analizohen dhe diskutohen dilemat etike gjatë përdorimit profesional të teknologjive të informacionit. Nëpërmjet shembujve konkretë ajo mbulon dhe zbërthen të gjitha fushat e studimit që lidhen me etikën, gjatë përdorimit të teknologjive informacionit.

- **E-mësimi 2.0 – teori dhe praktikë**

Si pjesë e kësaj lënde, studentët: - do të fitojnë njohuri për dizajnimin e programeve mësimore të bazuara në teknologji për mësimdhënie dhe mësimnxënie; - do të zhvillojnë aftësi që lidhen me potencialin për dizajnim të ligjëratave përmes mjeteve specifike të bazuara në teknologji; - do të fitojnë njohuri për mjetet moderne mësimore të bazuara në teknologji, duke përfshirë PC, teknologjitë multimediale dhe të komunikimit, si dhe si ato mund të përdoret për të ndihmuar mësimin; - do të fitojnë njohuri se si dizajnimet të ndryshëm të ligjëratave të bazuara në teknologji mund të ndihmojnë procesin e mësimin; - do të hartojnë plan për dizajnim dhe zhvillim të një moduli për e-mësim; - do t'i identifikojnë karakteristikat e modelit për e-mësim; - do të bëjnë analizë leksioni; - do të integrojnë strategji për mësimnxënie dhe mësimdhënie në planifikimin e dizajnit dhe zhvillimit të modulit.

- **Punimi i magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve që të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe për të bërë detyrën më të ndërlikuar - punimin e magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët të fitojnë njohuritë e nevojshme, por edhe aftësitë dhe shkathtësitë që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe stilit të shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, siç janë: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.

Lëndë zgjedhore

- **Puna me nxënës të talentuar**

Qëllimet e programit të lëndës: - Strategjitë, teknikat dhe metodat për punë me nxënës të talentuar; - Mënyrat e organizimit të punës, përkufizimi i fushave, përkufizimi i qëllimeve dhe detyrave dhe inkurajimi i ideve; - Metodrat dhe teknologjitë e kërkimit të burimeve të informacionit dhe shfrytëzimi i tyre; - Pjesë të zgjedhura nga fusha të ndryshme të TIK (risitë në TIK).

- **Aplikimi i teknologjive mobile dhe rrjeteve sociale në procesin e mësimnxënies**

Qëllimet e programit të lëndës: Në këtë lëndë do të prezantohen konceptet e përdorimit të aplikacioneve interaktive mobile dhe përdorimi i tyre në rrjetet sociale dhe në procesin e të mësuarit. Qëllimi është që të nxisë të mësuarit të nxënësi nëpërmjet përdorimit të mjeteve mobile për mësim dhe mediave sociale në arsim, që rrjedhimisht do të përgatisë nxënësit që të jenë pjesëmarrës aktiv dhe konstruktiv në botën tashmë shumë të ndërlikuar, në të cilën ata

jetojnë dhe së shpejti do të punojnë.

- **Përpunimi i të dhënave në arsim**

Qëllimet e programit të lëndës: - Njohja me konceptet e të dhënave dhe informacionit, llojet e të dhënave, të dhënat e rëndësishme për arsimin, klasifikimi i të dhënave; - Mënyrat e përpunimit të të dhënave, përpunimi matematik dhe statistikor i të dhënave; - Njohja dhe përdorimi me teknikat nga miniera e të dhënave (data mining); - Vizualizimi dhe prezentimi i të dhënave; - Njohja me vegla kompjuterike (Paketë softuerik) për përpunimin e të dhënave;

- **Matematikë**

Programi i kësaj lënde është dizajnuar ashtu që t'i trajtojë studentët me konceptet themelore matematikore dhe metodat të cilat janë të detyrueshme për përdorim të teknologjive informatike në mësimdhënie. Qëllimi është më shumë i drejtuar në njohjen e studentëve me konceptet bazë dhe me rezultatet matematikore, duke filluar nga barazimet dhe jobarazimet dhe zgjidhja e tyre. Një pjesë e rëndësishme janë strukturat diskrete (logjika matematikore, bashkësitë, relacionet, etj.). Po ashtu me rëndësi janë disa pjesë nga algjebra lineare të cilat janë të detyrueshme për zbatimin e koncepteve matematikore në arsim. Janë të nevojshme, gjithashtu edhe disa pjesë të kombinatorikës, si dhe funksionet dhe karakteristikat e tyre. Me rëndësi janë edhe nevoja e tyre në procesin e mësimdhënies. Qëllimi është që nxënësit të jenë në gjendje për mendim logjik në procesin e mësimdhënies, si dhe zbatimin e tyre praktik. Zbatimi praktik do të kryhet paralelisht nëpërmjet përdorimit të sistemeve kompjuterike-algjebrike, në mënyrë që qëllimet e lartpërmendura të mund të realizohen nëpërmjet përdorimit të teknologjive informatike.

- **Statistika e aplikuar**

Qëllimet e lëndës janë që studentët: - t'i fitojnë njohuritë e nevojshme nga fusha e statistikës, që kanë aplikim të drejtpërdrejtë në teknologjitë informatike, si dhe me përmbajtjet statistikore relevante dhe të duhura për nevojat mësimdhënëse dhe pedagogjike; - t'i fitojnë bazat e duhura për rëndësinë e parimeve dhe metodave statistikore, të cilat do të shoqërohen me aftësimin e tyre për analizë të të dhënave dhe sjelljen e konkluzioneve në bazë të analizave të bëra më parë; - t'i fitojnë njohuritë si përpunohen dhe si grupohen të dhënat statistikore, ligjshmëritë e tyre, prezantimi, ligjshmëritë e sjelljes së vendimeve adekuata në bazë të të dhënave të përpunuara, etj. Me këtë do të rritet perceptimi dhe të menduarit deduktiv te studentët.

- **Dizajnimi dhe evaluimi i rrethinave për mësim i bazuar në ueb**

Lënda synon të nxisë studentët të cilët dëshirojnë t'i mësojnë teoritë themelore për dizajnim të mësimnxënies e mësimdhënies si bazë në vlerësim dhe zhvillim të sistemeve të zbatuar në ueb apo aplikacionet e mësimin. Nëpërmjet leksioneve dhe diskutimeve, studentët do të kenë mundësi të përdorin dhe të analizojnë aplikacione të ndryshme konvencionale dhe mobile të bazuar në ueb dhe teknologjive të dedikuara për bashkëveprim dhe interaksion online. Studentët gjithashtu do të diskutojnë, do të këmbëjnë dhe do të aplikojnë strategji për dizajn të mjediseve online, të cilat e mundësojnë dhe e lehtësojnë mësimin interaktiv. Për të përfunduar lëndës, studentët do të formojnë grupe dhe do të punojnë si ekipe në zhvillimin e sistemeve të vegjël për mësim, të bazuar në ueb, si pjesë e projektit të tyre përfundimtar.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimin e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlihet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari l përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'ua tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathësi nga kapitujt e zgjedhur të

aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuara nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj studenti, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxënit si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorive dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikat, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillon kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasyshtë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.